

KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 1

RIKONSTRUKSIONI I REPARTIT TE FIZIOTERAPISE NE SPITALIN E TRAUMES

TIRANE

PROJEKT ZBATIMI DHE PREVENTIV PERFUNDIMTAR

“KKG” sh.p.k. - Tirane

SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI KKG

Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 2



PARAQITJE E PERGJITHSHME

Keto “Specifikime Teknike”, janë një dokument hartuar enkas nga KKG, për realizimin e projekt-ZBATIMIT: **“RIKONSTRUKSIONI I REPARTIT TE FIZIOTERAPISE NE SPITALIN E TRAUMES” TIRANE.**

Ky dokument te konsiderohet si pjese perberese e Dokumentacionit te Projektit Zbatimit dhe Preventivit Perfundimtar per objektin e mesiperm.

Kapitujt dhe Zerat e rradhitur ne permbajtje te ketyre specifikimeve teknike jane pjese dhe pershkrim i detajuar i vizatimeve te KKG, si dhe specifikime te tjera te mundshme te kategorive te ndryshme te punimeve ndertimore.

Kontraktoret e Punimeve te Ndertimit duhet t’u referohen specifikimeve teknike te atyre zerave te punimeve te cilat perfshihen ne pershkrimet e Vizatimeve, ne Preventivin Perfundimtar si dhe ne Pershkrimin e Punimeve.

Standartet e perdorura ne keto “Specifikime Teknike” dhe qe do te aplikohen me tej nuk mbeshteten vetem ne vizatimet, por edhe ne manualet ligjore dhe libra te tjere keshillues si:

- Manuali Nr.1 i “Analizat Teknike Prodhimi i Materialeve te Ndertimit” Tirane – (Republika e Shqiperise - Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave, me vendim Nr.1027, date 15.12.2010).
- Manual Nr.2 i “Analiza Teknike per Punimet e Ndertimit te Ndertësave”, Tirane – (Republika e Shqiperise - Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave, me vendim Nr.1027, date 15.12.2010).

LEGJENDA:

V.T.: Vizatime Teknike

P.P.: Pershkrimi i Punimeve

S.T.: Specifikime Teknike

1. PRISHJE DHE HEQJE KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 3

Public Health Sector

1.1. Prishje te pergjithshme

Prishja e teresise se nje godine ose nje pjese te godines duke perdorur çdo mjet, perfshire:

- puntelimet, skelen e sherbimit, marrjen e masave per aplikimin e te gjithe akteve perkatese te sigurise se mbrojtjes se punetoreve dhe popullsise,
- sinjalet e dites e te nates si dhe personelin per lajmerimin e kalimtareve,
- punimet per rrethimet e perkohshme,
- riparimin per demet e mundshme qe mund t'u shkaktohen te treteve dhe restaurimi i tubacioneve publike dhe private,
- ngarkimin e materialeve qe rezultojne nga prishja, perfshire transportin dhe shkarkimin.

1.2. Prishje me zgjedhje te materialit per riperdorim.

1.3. Prishje murature tulle.

1.3.1. me spostim.

1.3.2. Si ne piken e mesiperme 1.3.1, por me zgjedhje dhe pastrim.

1.4. Prishje mure dhe tavane te varura gipsi.

1.4.1. me spostim.

1.5. Prishje solete beton arme.

1.5.1. me spostim.

1.6. Prishje themele beton-arme.

1.6.1. me spostim.

1.7. Prishje shkalle te jashteme betoni.

1.7.1. me spostim.

1.8. Prishje arkitrare beton arme.

1.8.1. me spostim.

1.9. Çmontimi i strukture druri mbuluar me tjegull kanadeze.

1.9.1. me spostim.

1.10. Çmontimi i strukture metalike mbuluar me ondalux polikarbonat.

1.10.1. me spostim.

1.11.1. Prishje e shtresave te tarraces ezistuese.

1.11.1. perfshire hidroizolim dhe termoizolim.

1.11.2. heqje kasete e ulluke shkarkimi vertikale e horizontale

1.11.3. Si ne piken e mesiperme 1.10.1, por me stivim.

1.12. Prishje e veshje me pllaka gres ne tualete .

1.12.1. me spostim.

1.13. Prishje e shtresash me pllaka gres ne tualete.

1.13.1. me spostim.

1.14. Heqje zgara metalike ne dritare.

1.14.1. Si me siper, por me stivim.

1.15. Heqje grila plastike ne dritare.

1.15.1. Si me siper, por me stivim.

1.16. Heqje dyer MDF e duralumini, si dhe dritare.

1.16.1. Si me siper, por me stivim.

1.17. Heqje dyer te paloseshme ose divifleks

1.17.1. Me spostim

1.18. Heqje e pemeve ekzistuese per rimbjellje.

1.18.1. Si me siper, por me stivim.

1.19. Heqje e njesive te kondicionereve

1.19.1. Si me siper, por me stivim.

1.20. Heqje e sistemit hidraulik

Heqje e gjithë tubacioneve hidraulike ekzistuese deri ne tubacionin kryesor te hyrjes. Kontraktori do te kete pergjegjesi te plote per funksionimin e mire te tubacioneve kryesore qe vijne nga rrjeti publik deri tek objektet. Te gjithë tubat dhe pajisjet e hequra duhet te transportohen ne nje vend publik. Riperdorimi nuk lejohet ne asnje rast. **KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 5**

Public Health Sector

1.21. Heqje e sistemit elektrik

Heqja e te gjithë kabllave elektrike deri ne piken publike te furnizimit me energji elektrike. Te gjithë kabllot dhe pajisjet e hequra duhet te transportohen ne nje vend publik. Riperdorimi nuk lejohet ne asnje rast.

2. GERMIME DHEU

2.1. Zbankim dheu

Zbankim dhe rrafshim dheu, i kryer me krah ose mjet mekanik, ne truall te çfaredo natyre dhe konsistence, i thare ose i lagur (argjile edhe n.q.s. eshte kompakte, rere, zhavorr, gure etj.), duke perfshire prerjen dhe heqjen e rrenjeve, trungjeve, gureve dhe pjeseve me volum deri ne 0,30 m³, duke perfshire dhe plotesuar detyrimet ne lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave te zeza, tubacionet ne pergjithesi etj., perfshire transportin e te gjithë mbetjeve ne nje vend te autorizuar publik.

2.1.1. i kryer me krah.

2.1.2. i kryer me krah perfshire vendosjen brenda ambjentit te kantjerit te materialit qe rezulton.

2.1.3. i kryer me mjet mekanik.

2.1.4. i kryer me mjet mekanik perfshire vendosjen brenda ambjentit te kantjerit te materialit qe rezulton.

2.2. Germim dheu thellesi per themele, puse dhe punime nentokesore

Germim dheu per themele ose per punime nentokesore, deri ne thellesine 1,5 m nga rrafshi i tokes, ne truall te çfaredo natyre dhe konsistence, te thare ose te lagur (argjile edhe n.q.s. eshte kompakte, rere, zhavorr, gure etj.), perfshire prerjen dhe heqjen e rrenjeve, trungjeve, gureve dhe pjeseve me volum deri ne 0,30 m³, plotesimin e detyrimeve ne lidhje me ndertimet e nendheshme si kanalet e ujrave te zeza, tubacionet ne pergjithesi etj., perforcimin e çfaredo marke dhe rezistence, mbushjen e pjeseve qe mbeten bosh pas realizimit te themeleve me materialin e germimit te kryer me krah, si dhe transportin e te gjithë mbetjeve ne nje vend te autorizuar publik.

2.2.1. i kryer me krah.

2.2.2. i kryer me krah perfshire vendosjen brenda ambjentit te kantjerit te materialit qe rezulton.

2.2.3. i kryer me mjet mekanik.

2.2.4. i kryer me mjet mekanik perfshire vendosjen brenda ambjentit te kantjerit te materialit qe rezulton. **KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 6**

3. PUNIME BETONI

3.1. Markat e betonit

Raportet e meposhtme per betonin, perdorur ne punimet e ndertimit dhe referuar zerave specifike, jane te vleshme per 1(nje) m³ volum beton me çimento te zakonshme Portland. Keto standarte bazohen ne broshuren "Projektimi i Betoneve te Zakonshme, K.T. 37-75", date Tirane 1980 (Republika e Shqiperise-Ministria e Ndertimeve I.S.P.Nr. 1).

3.1.1. Beton marka C-7/10 me zhavorr natyror:

Çimento 300 kg 240 , zhavorr m³ 1,05 , uje m³ 0,19.

3.1.2. Beton marka C-7/10 me inerte, konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6:

Çimento 300 kg 240 , rere e lare m³ 0,45 , granil m³ 0,70 , uje m³ 0,18.

3.1.3. Beton marka C-16/20 me inerte , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6:

Çimento 300 kg 260 , rere e lare m³ 0,44 , granil m³ 0,70 , uje m³ 0,18.

3.1.4. Beton marka C-20/25 me inerte, konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6:

Çimento 400 kg 465, rere e lare m³ 0,38, granil m³ 0,64 , uje m³ 0,195.

3.1.5. Beton marka C-25/30 me inerte, konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rere e lare me modul 2,6:

Çimento 400 kg 465, rere e lare m³ 0,38, granil m³ 0,64 , uje m³ 0,195.

3. 2. Struktura mbajtese beton/arme, ky paragraf i referohet elementeve strukturor prej betoni dhe beton/arme, duke parashikuar nje fuge teknike (L=1/100h). Struktura duhet te realizohet me themele, skelete me trare, kollona, plinta, shkalle te lidhura ndermjet tyre, dhe te perfshije:

3.2.1. Shtrese betoni realizuar me beton C-7/10 me dozature per m³ sipas pikes

3.1.2., sipas udhezimeve ne vizatime, me beton (marka 100) te hedhur ne shtrese te holla dhe te vibruara mire, me dimensione dhe forma sipas fleteve perkatese te vizatimeve, duke perfshire kallepet, perforcimin, si dhe çdo gje tjeter te nevojshme per perfundimin e punes dhe realizimin e saj ne menyre perfekte.

3.2.2. Trare themeli beton/arme, te realizuar me beton C-20/25 me dozature per m³ sipas pikes 2.1.4., te armuar ne menyre te rregullt (hekur betoni mesatarisht 40kg/m³) sipas udhezimeve ne vizatime, me beton (marka 300) te hedhur ne shtrese te holla dhe te vibruara mire, me dimensione dhe forma sipas fleteve perkatese te vizatimeve, duke perfshire kallepet, perforcimin, skelen, si dhe çdo gje tjeter te nevojshme per perfundimin e punes dhe realizimin e saj ne menyre perfekte. **KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 7**

3.2.3. Plinta beton/arme realizuar me beton C-25/30 me dozature per m³ sipas pikes 3.1.5., te armuar ne menyre te rregullt (hekur betoni mesatarisht 40kg/m³) sipas udhezimeve ne vizatime, me beton (marka 300) te hedhur ne shtrese te holla dhe te vibruara mire, me dimensione dhe forma sipas fleteve perkatese te vizatimeve, duke perfshire kallepet, perforcimin, skelen, si dhe çdo gje tjeter te nevojshme per perfundimin e punes dhe realizimin e saj ne menyre perfekte.

3.2.4. Trare themeli beton/arme, te realizuar me beton C-25/30 me dozature per m³ sipas pikes 3.1.5., te armuar ne menyre te rregullt (hekur betoni mesatarisht 40kg/m³) sipas udhezimeve ne vizatime, me beton (marka 300) te hedhur ne shtrese te holla dhe te vibruara mire, me dimensione dhe forma sipas fleteve perkatese te vizatimeve, duke perfshire kallepet, perforcimin, skelen, si dhe çdo gje tjeter te nevojshme per perfundimin e punes dhe realizimin e saj ne menyre perfekte.

3.2.5. Kolona beton/arme brenda ose jashte strukturave te murit, te armuar ne menyre te rregullt (hekur betoni mesatarisht 60kg/m³) sipas udhezimeve ne vizatime, me beton (marka C 25/30) te vibruar mire, me dozature per m³ sipas pikes 3.1.5., duke perfshire kallepet, perforcimin, skelen, perforcimin me hekur si dhe çdo gje tjeter te nevojshme per perfundimin e punes dhe realizimin e saj ne menyre perfekte.

3.2.6. Trare te armuar, breza dhe arkitrare, te realizuar sipas udhezimeve ne projekt, me beton C 25/30, me dozim per m³ sipas pikes 3.1.5., duke perfshire skelat e shemit, kallepet, perforcimin, hekurin e armatures (hekur betoni mesatarisht 80kg/m³) si dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

3.2.7. Soleta me traveta h=30 cm, realizuar me beton C-25/30, sipas udhezimeve ne projekt, te vibruar mire, me dozim per m³ sipas pikes 3.1.5., duke perfshire hekurin e armatures, skelat e shemit, kallepet, perforcimin, si dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

4. PUNIME MURATURE

4.1. Murature tulle

4.1.3. Murature me tulla te lehtesuara dopio 25 dhe 38 cm dhe llaç bastard m-15, me dozim per m³: tulla nr. 205, llaç 0,29 m³, çimento (m-400) 44 kg dhe uje, per çdo trashesi perfshire çdo mjeshteri dhe material per dhembet e lidhjeve, qoshet, hapjet ne parapetet e dritareve, skelat e shemit dhe çdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e muratures dhe realizimin e saj ne menyre perfekte. Ne katin perdhe, muratura e tules do te ndertoht mbi nje shtrese bitumi me trashesi minimale 3 mm. Dy shtresa me bitum likuid te nxehte pranohen.

5. PUNIME SUVATIMI KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 8

Te gjitha siperfaqet qe do te suvatohen duhet te **lagen** me pare me uje. Aty ku eshte e nevojshme ujit do t'i shtohen materiale te tjere, ne menyre qe te garantohet realizimi i suvatimit ne menyre perfekte.

Ne çdo rast Kontraktori eshte pergjegjes i vetem per realizimin perfundimtar te punimeve te suvatimit.

5.1. Llaçi

Raportet e meposhtme per llaçin, perdorur per punimet e ndertimit dhe referuar zerave specifike, jane te vleshme per 1 (nje) m³ volum. Keto standarte bazohen ne Manualin nr.1 "Analizat Teknike per prodhimin e materialeve te ndertimit, udhezime dhe kritere" date Tirane - Dhjetor 2010 (Republika e Shqiperise - Ministria e Ndertimit).

5.1.1. Llaç bastard marka 15 me rere natyrale lumi (me lageshti, shtese ne volum 20% dhe porozitet 40%) e formuar me, çimento: gelqere: rere ne raporte 1: 0,8 : 8. Gelqere e shuar lt 110 , çimento 300 kg 150 , rere m³ 1,29.

5.1.2. Llaç bastard marka 25 me rere natyrale lumi (me lageshti, shtese ne volum 20% dhe porozitet 40%) e formuar me, çimento: gelqere: rere ne raporte 1: 0,5: 5,5. Gelqere e shuar lt 92 , çimento 300 kg 212 , rere m³ 1,22.

5.1.3. Llaç bastard marka 15 me rere te lare (porozitet 35%) e formuar me, çimento, gelqere, rere ne raporte 1: 0,8: 8. Gelqere e shuar lt 105, çimento 300 kg 144 , rere m³ 1,03.

5.1.4. Llaç bastard marka 25 me rere te lare (porozitet 35 %) e formuar me, çimento: gelqere, rere ne raporte 1: 0,5: 5,5. Gelqere e shuar lt 87, çimento 300 kg 206, rere m³ 1,01.

5.1.5. Llaç bastard marka 1:2 me rere te lare (porozitet 35%) e formuar me çimento, rere ne raporte 1:2. Çimento 400 kg 527 , rere m³ 0,89.

5.2. Suvatime & patinime

5.2.1. Suvatim i brendshem.

- Sprucim i mureve dhe i tavaneve, me llaç çimentoje te lenget per permiresimin e ngjitjes se suvase dhe rificimin e siperfaqeve te muratures, duke perfshire skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund sprucimit.

- Suvatim i realizuar nga nje shtrese me trashesi 2 cm llaçi bastard m-25 me dozim per m²: rere e lare 0,005 m³, llaç bastard (m-1:2) 0.03 m³, çimento (m-400) 6.6 kg, uje, i aplikuar, ne baze te udhezimeve te pergatitura ne mure e tavane, dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund suvatimit ne menyre perfekte.

5.2.2. Patinature ne siperfaqe gipsi KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 9

Patinature ne muret dhe tavanet e gipsit, mbi siperfaqet e stukuara dhe te niveluara me pare;

-patinatura do te realizohet me material te gatshem ne gjendje te thate, i cili perzihet me uje sipas udhezimit te vete produktit;

-duke perfshire skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund suvatimit ne menyre perfekte.

5.2.3. Suvatim i jashtem i zakonshem.

-Sprucim i mureve per murature, me llaç çimentoje te lenget per permiresimin e ngjitjes se suvase dhe rforcimin e siperfaqeve te muratures, duke perfshire skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund sprucimit.

- Suvatim i realizuar nga nje shtrese me trashesi 2 cm llaçi bastard m-25 me dozim per m²: rere e lare 0,005 m³, llaç bastard (m-1:2) 0.03 m³, çimento (m-400) 6.6 kg, uje, e aplikuar, ne baze te udhezimeve te pergatitura, ne mure e tavane, dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene plotesisht fund suvatimit ne menyre perfekte.

5.2.4. Suva plastike ne fasada.

-Realizimi ne fasada sipas V.T., suva plastike te bardhe me fuga, si dhe me ngjyrim;

-Kampion i ngjyrave te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak, si dhe ne konsultim me arkitektin.

6. SHITESA, DYSHEME DHE VESHJE

6.1. Shtrese toke dhe zhavorri.

6.1.1. Mbushje me inerte ndertimi e zones se percaktuar ne projekt, e ngjeshur mire, qe rezulton nga prishjet e ndertimit ne Kantjer, e sistemuar ne disa shtresa deri ne lartesine qe tregohet ne V.T.

6.1.2. Shtrese toke, e ngjeshur mire, qe rezulton nga germimet ne Kantjer ose transportet nga jashte kantjerit, e sistemuar ne disa shtresa deri ne lartesine qe tregohet ne V.T.

6.1.3. Shtrese çakelli t=40cm, dhe zhavorri t=30cm, sipas V.T., mbi terrenin e ngjeshur mire me perpara, me zhavor lumi pa perberje argjilore dhe me lartesi sipas udhezimeve ne projekt, si dhe çdo detyrim tjeter per ti dhene fund punes.

6.2. Shtrese betoni.

6.2.1. Beton i lehtesuar t=12cm, sipas V.T., i hedhur ne veper mbi per mbushje mbi dyshtemen ekzistuese, formuar nga shtresa te holla te niveluara mire, duke perfshire çdo detyrim tjeter per mbarimin e punes ne menyre te rregullt.

6.2.2. Shtrese betoni realizuar me beton C-16/20 me dozature per m³ sipas pikes 3.1.3., sipas udhezimeve ne vizatime, me beton (marka 200) te hedhur ne shtrese te holla dhe te vibruara mire, me zgare hekuri Ø 10mm, 20x20cm, me dimensione dhe forma sipas **KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 10**

fleteve perkatese te vizatimeve, duke perfshire kallepet, perforcimin, si dhe çdo gje tjeter te nevojshme per perfundimin e punes dhe realizimin e saj ne menyre perfekte.

6.2.3. Dysheme me lluster çimento me trashesi minimale 5 cm, mbi siperfaqet e percaktuara sipas detajeve te V.T., i zbatuar me llaç çimentoje m-1:2, i lemuar ne siperfaqe me mistri dhe pluhur çimentoje, duke perfshire çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te dyshemese ne menyre perfekte.

6.2.4. Dysheme lluster çimento me kuarç me trashesi minimale 3cm, vendosur mbi siperfaqet e percaktuara sipas V.T., zbatuar me llaç çimentoje m-1:2 dhe kuarç, trajtim special me helikopter, duke perfshire çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te dyshemese ne menyre perfekte.

6.3. Dysheme te reja.

6.3.1. Dysheme me pllaka gres porcelanat, te cilesise se pare (me permasa 60x60cm) te tipit te zgjedhur, perfshire :

- ngjitja pllakave realizohet me shtrese kolle,
- prerjen me prerres pllakash dhe ngulitjen e inkastrimeve ne mur, vendosjen ne veper ne menyre plotesisht te ngjeshur ndermjet tyre dhe te stukuara me boiake çimentoje ne fugatura,
- larjen dhe pastrimin,
- çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te dyshemese ne menyre perfekte.

Kampione e propozuar duhet t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per nje aprovim paraprak.

6.3.2. Dysheme me pllaka gres ne nyjet sanitare, te tipit te zgjedhur, perfshire :

- ngjitja pllakave realizohet me shtrese kolle,
- prerjen me prerres pllakash dhe ngulitjen e inkastrimeve ne mur, vendosjen ne veper ne menyre plotesisht te ngjeshur ndermjet tyre dhe te stukuara me boiake çimentoje ne fugatura,
- larjen dhe pastrimin,
- çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te dyshemese ne menyre perfekte.

Kampione e propozuar duhet t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per nje aprovim paraprak.

6.3.3. Dysheme me shtrese rezine mat StoPox WB, aplikuar me shpatull, me primer epoxid, mbi shtrese lluster çimento me kuarç dhe sheshuar me helikopter e pergatitur me pare dhe e thare mire;

- vendosjen ne veper ne menyre plotesisht te njetrajtshme pa fugature;
- larjen dhe pastrimin;
- çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te dyshemese ne menyre perfekte.

Kampione e propozuar duhet t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per nje aprovim paraprak.

6.3.4. Dysheme me parket laminat, sipas V.T., te cilesise se pare te tipit te zgjedhur, perfshire : **KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 11**

-parketi laminat sebashku me shtresen niveluese dhe plintus, mbi nje siperfaqe te parapregatitur, te niveluar mire, te pastruar dhe plotesisht te thare;

-ngjitesi i perdorur per fiksimin e tij do te jete i pershtatshem pikerisht per kete qellim dhe me nenshtresen perkatese e cila do te hidhet mbi siperfaqen e parapregatitur;

-pastrimi i siperfaqes;

-çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te dyshemese ne menyre perfekte;

Kampione e propozuar duhet t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per nje aprovim paraprak.

6.3.5. Shtrese me perberje gome, me lartesi t=1.5cm, venosur mbi shtrese lluster çimento me kuarç dhe sheshuar me helikopter, sipas V.T. dhe udhezimeve ne projekt;

-ngjitja realizohet me ngjtes te posaçem,

-prerjen me prerës dhe ngulitjen e inkastrimeve ne mur, vendosjen ne veper ne menyre plotesisht te ngjeshur;

-larjen dhe pastrimin,

-çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te dyshemese ne menyre perfekte.

Kampionet duhet t'i paraqiten me perpara Supervizorit te Kantjerit.

6.3.6. Materiali çakelli i ruluar, per totuar t=15 cm

Materiali i nënshtresës (subase) do te hidhet me dore deri ne trashësinë dhe nivelet e duhura dhe plotësisht i ngjeshur me pajisje te përshtatshme, për te fituar densitetin specifik ne tere shtresën me përmbajtje optimale lagështie te përcaktuar { + 1-2%}.

6.3.7. Shtresa mbi baze me stabilizant per totuar t=10 cm

a-Agregatet (inertet) e perdorura per shtresen e Bazes, te perbere prej gureve te thyer do te merren nga burime te caktuara ne zonat e karrierave. Punimet e dherave nuk do te permbajne material copezues,(prishes), si p.sh. pjese shkembinsj te dekompozuar ose material argjilor.

6.3.8. Ndertim trotuari me pllaka dekorative te presuara betoni;

-shtrese betoni C-7/10, me trashesi t=5 cm, me dimensione te pllakave 50x50cm, me nivelin dhe pjerresine e specifikuar ne vizatimet teknike mire;

-pllaka te presuara, te vendosura ne veper mbi nje shtrese llaçi, duke perfshire pastrimin, si dhe çdo detyrim tjeter dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

6.3.9. Bordura betoni.

-furnizim dhe vendosje ne veper te bordures se parafabrikuar ose te bere ne veper me beton C-16/20, me permasa 25x30cm dhe gjatesi te ndryshueshme siç tregohet ne vizatime, me nje lartesi te futur nen dhe prej 15 cm;

-çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

6.4. Veshje

6.4.1. Veshje me pllaka gres porcelanat, per nje lartesi 2.2 m te mureve, me pllaka gres porcelanat te zgjedhur te cilesise se pare, furnizuar dhe vendosur ne veper mbi

nje sipërfaqen e përgatitur me parë, e ngjitur me llaç me dozim në m²: rere e lare 0,005 m³, çimento (m-400) 4 kg, stukim me çimento të bardhë, pastrim i plote, skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e veshjes në mënyrë perfekte. **KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 12**



Pllakat ne qoshe, nese eshte e nevojshme, do te priten me prerres te pershtatshem pllakash, do te shpohen me shpues dhe nuk do te nderpriten aty ku ka pajisje sanitare.

6.4.2. Veshje me pasqyra ne mure, dimensionet sipas V.T.

-Pasqyrat duhet te jene me $t=7\text{mm}$, ngjitja realizohet mbi siperfaqe gipsi te stukuara e lemuara me pare;

-Vendosur ne mure me ngjites te posaçem, si dhe aksesore ne bashkimin e fleteve;

-skelat dhe çdo detyrim tjeter dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte;

-Kampionet e propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak, si dhe ne konsultim me arkitektin.

6.6. Plintusa

6.6.1. plintus me pllaka gres, me lartesi 8 cm dhe trashesi 1,5 cm, i vendosur ne veper me llaç me dozim per m^2 : rere e lare $m^3 0.005$, çimento (m-400) 4 kg dhe uje, duke perfshire stukimin, pastrimin si dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

6.6.2. Plintus druri, me lartesi 10 cm dhe trashesi 1 cm, i vendosur ne veper me me ngjites te psaçem, duke perfshire stukimin e pastrimin, si dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

6.6.3. Profila alumini ne dysHEME, me gjeresi 3 cm, i vendosur ne veper me me ngjites, duke perfshire pastrimin, si dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

7. PUNIME ME KARTON XHES

7.1. MURE KARTON XHES

7.1.1. Mure ndarese me karton xhes $t=12\text{cm}$, te cilat montohen me profile metalike 100 mm çdo 62.5 cm ele-kendore, lesh guri $40\text{ kg}/m^3$, ne hapesiren e brendshme te murit vendoset lesh guri me dendesi indikative $40\text{ kg}/m^3$;

-si dhe duke realizuar stuko karton xhesi ku eshte e nevojshme ne bashkimet;

-duke perfshire riparimet e mundeshme, si dhe çdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

7.1.2. Mure ndarese me karton xhes $t=12\text{cm}$, zeizoluese me lesh guri

-vendosjen e dy pllakave karton xhesi me $t=12.5\text{mm}$, te cilat montohen profile metalike 100 mm çdo 62.5 cm dhe ele-kendore;

-si dhe duke realizuar stuko karton xhesi ku eshte e nevojshme ne bashkimet;

-duke perfshire riparimet e mundeshme, si dhe çdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte. **KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 13**

7.1.3. Mure me panele çimentato;

- vendosjen e dy pllakave gips çimentato me $t=12\text{cm}$, me profile 100 mm çdo 62.5 cm te cilat montohen me profila metalike dhe ele-kendore;
- si dhe duke realizuar stuko karton xhesi ku eshte e nevojshme ne bashkimet;
- duke perfshire riparimet e mundeshme, si dhe çdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

6.2. TAVANET E VARURA

6.2.1. Tavane te varura

Do te jene me karton xhes i kombinuar me pllaka me fibra minerale, si dhe me elementet konstruive mbajtes me te cilin do te realizohen, ne ambientet e specifikuara sipas V.T.

- skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte; Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak.

6.2.2. Tavane te varura ne nyjet sanitare:

Tavanet e varura do te jene kundra lageshtires, sipas V.T., si dhe me elementet konstruiv mbajtes me te cilin do te realizohet.

- skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte; Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak.

8. TARRACA & RIPARIM ÇATIE DHE PANEL SANDWICH

8.1. Meremetimi i çatise ekzistuese:

- Riparimi i çatise me konstruksion druri do te behet atje ku gjendja e saj rezulton e demtuar pas vzhgimit ne vend;
- zevendesim i listelave ekzistuese 5x3 cm çdo 33 cm per fiksimin e tjegulles;
- zevendesimi i tjegullave tip "Vendi";
- Skelat e sherbimit ose skelerine si dhe çdo detyrim dhe punim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.
- Kampionet duhet t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit perpara.
- Çdo gje tjeter te nevojshme per perfundimin dhe realizimin e mbuleses se palestres ne menyre perfekte;

8.2. Mbulese me panel sandwich

Mbulese me panel sandwich per strukturen metalike, vendosje e montim te paneleve te gaeshme, sipas V.T.;

- çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te mbuleses ne menyre perfekte.

8.3. Hidroizolimi i tarrace

Tarraca KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 14

- Formim i pjerresive mbi siperfaqen plane me beton te lehtesuar (stirobeton), me trashesi mesatare 8 cm, per te patur nje pjerresi sipas udhezimeve ne projekt, 0,4 kg, e vene ne veper per te formuar nje siperfaqe unike.
- Shtrese lluster çimento me trashesi 3cm, me dozim si me siper, e niveluar dhe pastruar per vendosjen e membranës hidro-izoluese;
- Shtrese avull-izoluse me bariere alumini, vendosur perpara shtresës termoizoluese;
- Vendosja (perpara hidroizolimit) te kasetave te reja te taraces me llamarine te xinguar, dhe çdo gje tjeter te nevojshme per te garantuar funksionimin perfekt te sistemit te drenazhimit;
- Realizimi, ne pjesen e brendshme te parapeteve te pasuvatuar te tarraces (nese ka) ne lartesine 30 cm, te nje ulluku per vendosjen e membranës hidroizoluese;
- Shtrese hidro-izoluese, mbi siperfaqe te thare dhe te niveluar me pare, duke perfshire pjesen vertikale, me te gjithë kendet dhe qoshet e rrumbullakosura mire me pare, trajtuar me nje dore praimer, dhe dy shtresa guaine me ngjitje 100%.
- Shtrese mbrojtese me batanije artificiale gjeotekstil, me llaç çimento 1:2 mbi shtresen hidroizoluese, me trashesi minimale prej 3 cm;
- Mbi siperfaqet vertikale, te dy shtresat e guainos do te ankorohen ne kanalet e murit, te fiksuara fort ne fillim me gozhde dhe me pas me llaç çimento.
- Suvatim perfundimtar i siperfaqeve vertikale te parapeteve te taraces (nese ka), per perfundimin e vendosjes se membranave hidroizoluese;
- Shtrese beton granili me trashesi 4 cm, me zgare te elektrosalduar Ø 6mm, çdo 20cm;
- Veshje parapeti me llamarine te xinguar, per gjate gjithë perimetrit, sipas V.T.;
- Veshje me imluve pergjate bashkimit te tarraces me catine
- Vendosje e ulluqeve ne pusetat e shiut;
- Çdo gje tjeter te nevojshme per perfundimin dhe realizimin e taraces ne menyre perfekte;

8.4. Ulluqe vertikale.

8.4.1. Ulluk vertikal me tuba me llamarine te plastifikuar, me diameter minimal 10 cm dhe trashesi 0,8 mm. Ne çdo ulluk duhet te mblidhen ujrat e nje siperfaqe te tarraces jo me te madhe se 80 m².

Ulluket duhet te vendosen ne pjesen e larta te nderteses me ane te qaforeve perkatese prej hekuri te xinguar, te fiksuar mbi parete çdo 2 m. Ujrat e tarraces duhet te mblidhen nepermjet nje pjate prej llamarine te xinguar, te veshur me dy membrana bitumi te **KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 15**



vendosura ne flake, me trashesi 4 mm, te vendosur ne menyre te terthorte ndermjet muratures dhe parapetit, me pjerresi 1%, sipas udhezimeve ne projekt. Pjesa fundore e ullukut, per lartesine 3 m, do te mbrohet me tub hekuri te rende me trashesi minimale 4 mm.

Ne fund nje tub i kthyer 90 grade do te saldohet dhe mberthehet fort me ganxha hekuri

8.5. Ulluk horizontal.

8.5.1. Ulluk horizontal ne strukturen metalike me tuba me llamarine te plastifikuar, me diameter minimal 10 cm dhe trashesi 0,8 mm. Ne ulluqe duhet te mblidhen ujrat e nje sipërfaqe te tarraces jo me te madhe se 80 m².

Ulluku duhet te vendoset ne pjesen e larta te nderteses me ane te qaforeve perkatese prej hekuri te xinguar, te fiksuar mbi parete çdo 2 m. Ujrat e tarraces duhet te mblidhen nepermjet nje pjate prej llamarine te xinguar, te veshur me dy membrana bitumi te vendosura ne flake, me trashesi 4 mm, te vendosur ne menyre te terthorte ndermjet muratures dhe parapetit, me pjerresi 1%, sipas udhezimeve ne projekt.

8.6. Hidroizolim i dyshemese.

Shtrese hidro-izolimi per dyshemene e shteses, me nje flete guajne M-3 me 3,8 kg/m² + prajmerin. Guajna do te vendoset deri ne lartesine 20 cm mbi muret e pasuvatuar te ambjenteve.

Kampionet do t'i paraqitenn Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak. Çdo detyrim tjetër dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

8.7. Hidroizolim i nyjeve sanitare.

Shtrese hidro-izolimi per te gjitha dyshemetë e nyjeve sanitare, e perbere nga nje shtrese guaino M-3 me 3,8 kg/m² + prajmerin,

Kampione te guainos dhe ngjitesit te propozuar do t'i paraqitenn Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak.

Çdo detyrim tjetër dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

9. DYER DHE DRITARE

9.1. Dritare & Vetrata

9.1.1. Dritare duralumini plastike: furnizim dhe vendosje dritare, me dopio xham, te bardha, permasat e se ciles duhet te verifikohen nga nderrmarja ne kantjer, e perbere nga:

-vendosja me pare e davancaleve te mermerit permasat do te maten ne vend;

-me kanata te hapeshme, duralumini me ngjyre te bardhe sipas V.T.;

-vendosje e rrjete teli mbrojtese ne dritare;

-vendosje e grilave duralumini ne dritare;

-duke perfshire riparimin e patuarve, si dhe çdo paisje tjetër per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak, si dhe ne konsultim me arkitektin. **KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 16**



9.1.2. Vetrata duralumini plastike: furnizim dhe vendosje e vetaratave, siç pershkruhet ne V.T., permasat e te cilave duhet te verifikohen ne vend nga Kontraktori;

-vendosja me pare e davancaleve te mermerit permasat do te maten ne vend;
-me kanata te hapeshme, duralumini me ngjyre te bardhe, me dopio xham, sipas V.T.;

-E gjithë vepra e muratures si dhe çdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak.

9.1.3. Vetrata duralumini te brendeshme : furnizim dhe vendosje e vetaratave me xham opak (jo transparent) tek $t=9\text{mm}$, siç pershkruhet ne V.T., permasat e te cilave duhet te verifikohen ne vend nga Kontraktori;

-vendosja me pare e davancaleve te mermerit permasat do te maten ne vend;
-me kanata te hapeshme, duralumini me ngjyre te bardhe, me dopio xham, sipas V.T.;

-E gjithë vepra e muratures si dhe çdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak.

9.1.4. Vendosje perde te plastifikuar, te vendosura sipas V.T.

Materiali i perdes duhet te plotesoje kushtet e funksionit :

-Copa e materialit beze e plastifikuar;

-Pesha e siperfaqes 200 gr/m^2 ;

-menyra e vendosjes eshte e varur ne shufer metalike;

-Kampione e propozuara duhet t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per nje aprovim paraprak, si dhe ne konsultim me arkitektin.

-skelat dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te vendosjes ne menyre perfekte.

9.2. Dyer.

9.2.1. Dyer te brendshme tamburato MDF me kase derase dhe brave, vendosja e percaktuar sipas V.T.

-Furnizim dhe vendosje ne veper dyer te brendshme me nje kanat, me ngjyre te e permasa sipas V.T. perzgjedhja e tyre do te behet ne konsultim me arkitektin, duhet te percaktohen nga Kontraktori, te perbera nga:

-nje kontratelajo ne dru pishe te staxhionuar (me trashesi 3 cm) e imprenjuar, me permasa sipas gjeresise se murit (qe rritet si pasoje e veshjeve te ndryshme te murit), qe do te fiksohet ne mure me fasheta te pershtatshme hekuri (çdo 1 m) dhe me llaç çimento.

-nje telajo druri, qe do te vidhohet ne kontratelajo pas punimeve te suvatimit dhe bojatisjes. Sipas vizatimit te deres ne V.T., telajoja do te pajiset me mentesha dhe bllokuese te pershtatshme sipas tipit te deres, etj.

-brava e sigurise dhe çeles, doreza tunxhi, dhe piastra e gojeza perkatese.

E gjithë vepra e muratures si dhe çdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak ne konsultim me arkitektin. **KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 17**



9.2.2. Dyer MDF me kase derase dhe doreza antipanik, ne tualetet PAK.

-Furnizim dhe vendosje ne veper dyer te brendshme me **nje kanata me hapje 180°**, permasat e se ciles sipas V.T. perzgjedhja e tyre do te behet ne konsultim me arkitektin, duhet te percaktohen nga Kontraktori, te perbera nga:

-nje kontratelajo ne dru pishe te staxhionuar (me trashesi 3 cm) e imprenjuar, me permasa sipas gjerese se murit (qe rritet si pasoje e veshjeve te ndryshme te murit), qe do te fiksohet ne mure me fasheta te pershtatshme hekuri (çdo 1 m) dhe me llaç çimento.

-nje telajo druri, qe do te vidhohet ne kontratelajo pas punimeve te suvatimit dhe bojatisjes. Sipas vizatimit te deres ne V.T., telajoja do te pajiset me mentesha dhe bllokuese te pershtatshme sipas tipit te deres, etj.

E gjithë vepra e muratures si dhe çdo paisje tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Kampione te artikujve te propozuar do t'i paraqiten Supervizorit te Kantjerit per aprovim paraprak ne konsultim me arkitektin.

10. PUNIME METALIKE

10.1. Konstruksione metalike, ne korridorin e hyrjes, sipas V.T. te projektit konstruktiv.

-Lyerje me disa duar boje vaji sintetik (0.2 kg/m²) mbi siperfaqet e tyre, deri ne mbarimin e punes ne menyre perfekte.

-Skelat e sherbimit ose skelerine si dhe çdo detyrim dhe punim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte;

-Çdo punim dhe mjeshteri te nevojshem per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

-Kampionet duhet t'i paraqiten me perpara Supervizorit te Kantjerit.

10.2. Hekur

Public Health Sector

Punime hekuri per te gjitha strukturat e betonit te perforcuara Ø 10 dhe mbi 10 sipas V.T., qe do te prodhohen ne kantjer, duke marre ne konsiderate te gjitha kerkesat per tipet Ç-500s, me Rak = 4000 daN/cm² dhe jo te ndryshkur, ne madhesi dhe forme sipas udhezimeve te vizatimeve dhe standarteve teknike ligjore per perkuljet, fugat etj. dhe duke patur parasysh sigurimin me çertifikata nga labororet per te verifikuar qe hekuri i ploteson kushtet per t'u perdorur ne punime, dhe duke perfshire te gjitha detyrimet e tjera per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

11. PUNIME BOJATISJE

11.1. Bojatisje me hidromat.

11.1.1. Bojatisje me hidromat veteajroses per tavane, stukimin dhe lemimin e suvase me stuko sintetik, aty ku eshte e nevojshme, per te patur te gatshme dhe ne

menyre perfekte siperfaqet per lyerje. **KKG Project SPECIFIKIME TEKNIKE-PUNIME NDERTIMI 18**



Public Health Sector

Mbrojtja me leter e siperfaqeve qe nuk do te lyhen.

Nje dore te vetme praimer te pershtatshem, te aplikuar me furçe mbi mure dhe tavane.

Bojatisje me tre duar te mureve dhe tavaneve me hidromat, te bardhe ose me ngjyre, deri ne mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Çdo punim dhe mjeshteri te nevojshem per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

Kampionet duhet t'i paraqiten me perpara Supervizorit te Kantjerit.

11.1.2. Bojatisje me hidromat per mure, stukimin dhe lemimin e suvase me stuko sintetik, aty ku eshte e nevojshme, per te patur te gatshme dhe ne menyre perfekte siperfaqet per lyerje.

-Mbrojtja me leter e siperfaqeve qe nuk do te lyhen (profilet e dyerve dhe dritareve, plintusa, dysHEME, etj.).

-Nje dore te vetme praimer te pershtatshem, te aplikuar me furçe mbi mure.

-Bojatisje me tre duar te mureve me hidromat, te bardhe ose me ngjyre, deri ne mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Çdo punim dhe mjeshteri te nevojshem per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

Kampionet duhet t'i paraqiten me perpara Supervizorit te Kantjerit.

11.1.3. Bojatisje mbi siperfaqe metalike me boje vaji

Kerkohet paraprakisht nje dore e vetme praimer ose boje kunder ndryshkut, me dozim 0.08 kg per m².

-Lyerje me disa duar boje vaji sintetik (0.2kg/ m²) deri ne mbarimin e punes ne menyre perfekte.

-Çdo punim dhe mjeshteri te nevojshem per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

-Kampionet duhet t'i paraqiten me perpara Supervizorit te Kantjerit.

"KKG" sh.p.k.

Ark.Henri ALEKSI
Administrator

Public Health Sector